



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 312/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur ndaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të keqpërdorimit të pozitës zyrtare nga ana e kirurgut të SHSKUK, Skender Shabani, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.312/2019 e datës 06.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). me seli në Prishtinë, për shkak të keqpërdorimit të pozitës zyrtare nga ana e kirurgut të SHSKUK, Skender Shabani, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

Me datë 06.10.2019, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka paraqitur në PZAP, ankesën Anr.312/2019, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar, se me datë 06.10.2019, rreth orës 13:20, kanë marrë një informatë nga Baton Kelmendi, se kirurgu nga SHSKUK, Skender Shabani, ka hyrë në dhomë të pacientëve duke kërkuar që të votohet Partia Demokratike e Kosovës (PDK), veprim ky i cili sipas paraqitësit të ankesës bie në kundërshtim me nenin 35 par.1 të LZP-së, pasi që nga ana e kirurgut Skender Shabani, nga pozita e tij si shërbyes publik, në institucion publik, ka kryer veprime të ndaluara. Për këtë rast ankuesi e ka njoftuar Prokurorinë dhe Policinë e Kosovës. Ndërsa PZAP-it, i ka propozuar që shkelësi të sanksionohet në përputhje me legjislacionin zgjedhor.

Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). me seli në Prishtinë, në përgjigje në ankesë, të datës 07.10.2019, ka konsideruar se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, me arsyetimin Skender Shabani, si person përgjegjës në QKUK e në bashkëpunim me KQZ-në, kanë njoftuar pacientët të cilët kanë të drejtë votimi. PZAP-it, i kanë propozuar që ta hudhë ankesën, përgjigjes në ankesë i është bashkangjitur kopje të email-it, të dërguar nga Drejtoria SHSKUK, në cilësi të provës materiale.

PZAP-i, me qëllim që të hetohet rasti në fjalë i është drejtuar Policisë së Kosovës – DRP – Prishtinë, të cilët në Raportin e tyre të 06.10.2019, lidhur me informatën për njësinë mobile në QKUK, kanë njoftuar se me datë 06.10.2019 rreth orës 14:20 nga prokurori Armend Hamiti është pranuar një informatë me dyshimin se një person është duke bërë presion tek pacientët për të votuar për subjektin politik të PDK-së. Pas marrjes së kësaj informate janë ndërmarrë veprimet e nevojshme lidhur me hetimin e rastit, ashtu që është vizituar lokacioni

në të cilin pretendohet se ka ndodhur shkelja - QKUK, janë marrë në pyetje disa nga votuesit të cilët kanë mohuar se kirurgu Skender Shabani ka bërë presion tek ta gjatë votimit. Po ashtu nga prokurori Arian Gashi nga KKZ-ja, është vërtetuar se edhe ata janë në njohuri se kirurgu Skender Shabani është i caktuar që ta shoqërojë njësinë mobile të votimit si person i autorizuar nga drejtori i QKUK-së, Basri Sejdiu. Dhe nga i gjithë ky hetim, prokurori Armend Hamiti ka vlerësuar, se kjo mund të jetë një informatë e rrejshme dhe se nuk është e nevojshme të ndërmerren veprime tjera lidhur me këtë rast.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Në rastin konkret, Paneli nuk mundi të konstatoj se nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është shkelur dispozita ligjore e LZP-së, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, për faktin se paraqitësi i ankesës, ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi për të argumentuar pretendimet e tija, se nga ana e kirurgut Skender Shabani, është keqpërdorë pozita e tij publike, në hapësirat e një institucioni publik, respektivisht të SHSKUK, me qëllim të përfitimit të votave për subjektin politik PDK.

Po ashtu edhe nga raporti i Policisë së Kosovës, të datës 06.10.2019, vërtetohet se nga ana e kirurgut Skender Shabani nuk është bërë ndonjë shkelje, e cila sanksionohet me dispozitat ligjore të LZP-së dhe rregullave zgjedhore, pasi që hetimi i ndërmarrë nga organet e Prokurorisë së Shtetit, ka rezultuar thjesht si një informatë e rrejshme, pa elemente të ndonjë veprë penale.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk rezulton se në këtë rast ka ndodhur shkelje e dispozitave ligjore të LZP-së, e as e rregullave të KQZ-së, dhe për rrjedhojë nuk ka bazë ligjore që ndaj subjektit politik PDK, të shqiptohet gjobë në kuptim 120 par 1 pika c) të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, nenit 117 dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.312/2019 më datën 07.10.2019

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.*

